

LETËRSIA E LUGINËS SË PRESHEVËS MES DHEMBJES DHE EKSODIT

Shefat ADEMI¹

¹ Corresponding author e-mail: shefatademi1@gmail.com

Përmbledhje

Punimi im synon të hedhë në dritë, periudhën më të rëndë në të cilën po krijohet letërsia e Luginës së Preshevës në një kohë mjaft të errët të fillimit të shek. XX. Fazat në të cilën kaluan shumë krajata, e bën të mundur që të krijohet një letërsi e pastër që kishte synim senzibilizimin e kësaj treve me trungut Shqipëri Kosovë. Ngjarjet që rrodhën, si Lufta e Kosovës, Referendumi i 1e 2 marsit 1992 kur Lugina e Preshevës nuk i'u bashkua Republikës së Kosovës, pikërisht mu këtu filluan shpërnguljet masive nëpër viset e tjera shqiptare madje edhe në diasporë e gjetiu. Kalibri i shkrimtarëve preshevarë, udhëtoi nëpër një rrugë e cila ishte e mbjellur me dhembje e lot, por që këto dyja u shndërruan në forcë për të vazhduar edhe më tutje për ta vetëdijësuar popullin nëpërmjet letërsisë reale që do krijohet më pastaj. Epiqendrat më të rëndësishme, ku do të krijohet letërsia e autorëve preshevarë do ta ketë adresën si në Kosovë, Zvicërr, Kanada, ku nga atje do të dalin veprat më të mira e më të kulluara me tematikë vendlindje. Punimi është rezultat i punës shumë dimensionale që synon të përbush gjithë vlerën dhe potencialin që këta autorë përmes veprave të tyre arritën, ta ngrënë në piadestal dëshirën, që një ditë ta shohin Luginën e Preshevës, të zhvilluar ekonomikisht, të lirë, dhe të bashkuar me Republikën e Kosovës.

Fjalët kyçe: mall, shkrimtarë, sakrificë, luftë, iniciativë, vepra.

Treva në të cilën populli shqiptar, u nëpërkëmb saherë që të tjerët deshën ta zhbëjnë fund e krye pati një destinacion të quajtur Luginë e Preshevës. Ajo kultivoi me dekada, arën më të sertë të letërsisë atë dhembjes dhe eksodit që me shekuj e dekada ende kullon gjak. Malli për ta parë këtë trevë, njëherë e përgjithmonë të lirë nga okupatorët sllavë, ishte në mendjen e gjithsecilit, por edhe pse mundësia e kufizuar dëshmoi të kundërtën ku shumë intelektualë, ushtarë, shkrimtarë të detyruar nga reprezaljet e vazhdueshme dhe përndjekjes së tyre si hije egërsirash, mundësia e fundit për ta shpreh mallin e këtij mëmëdheu të djegur shpirtërisht, adresën do ta ketë dhembja dhe eksodi masiv që u bë plagë e pashëruar te gjithë shkrimtarët preshevarë.

Me të mësuar letërsinë e Rilindjes Kombëtare, që thajse ngjasonte me këtë motiv ajo zgjoi kureshtjen tek doajenët e letërsisë se historia e njëjtë kishte trokitur edhe këtu, por se parapërgatitjet për një model të tillë thajse ishin gati. Modeli i njëjtë sikur me shqiptarët, që në kohën e Rilindjes u deshën të shpërngulen në gjithë viset e botës, për ta shpreh mallin që e kishin lënë për mëmëdheun e robëruar nga mizoritë turke, e njëjta u përsërit edhe në Luginë të Preshevës në shekullin e XX, por me një okupator të ardhur nga karpitet me emrin serb.

Këto katrahura, që ndodhën me fillimin e këtij shekulli shënuan një epokë të rëndësishme sepse historia po shkonte mbrapsht për shqiptarët, ku treni i fundit tashmë kishte ngecur në rrugën në të cilën gjembat vetëmse kishin filluar të shponin zemrat e këtyre shqiptarëve, që

Lugina e Preshevës nuk arriti të bashkohen me Kosovën, ku dhe gjenerata të tëra u tretën pa nam e nishan.

Si u bë që shekulli XX, të sjellë tek shqiptarët gjakun martir në këmbim të lirisë ku shtetet që i'a kishin mësyre ta gëlltitnin nderin e shqiptarit, e bënë vasale Jugosllavinë e Rankoviçit, Çubrilloviçit, e së fundmi Millosheviçit. Të njëjtin fat sikurse De Rada, Serembe, Naimi, Samiu, të njëjtën e patën edhe shkrimtarët preshevarë si: *Mustafë Ismaili, Reshat Avdiu, Hasan Emërllahu, Sadik Sadiku, Mexhid Mehmeti, Jonuz Fetahaj* e shumë të tjerë që nxorën në pah veprat më të mira me motive të dhembjes, por edhe të krenarisë duke mos e harruar asnjëherë vendin në të cilën u rritën, edukuan dhe në fund u detyruan ta lënë atdheun e tyre.

Diaspora u pa me një dioptri tjetër, por që ishte mundësia e fundit për ta zënë trenin i cili po ecte me një shpejtësi të cilën askush nuk mundte ta dinte fillin. Epiqendrat ku letërsia e Luginës u zhvillua në Kosovë, Zvicërr, Kanada e bënë të mundur shpërfaqjen e mallit, që këta intelektualë që sot janë gjallë kur i dëgjon ligjërimet e tyre thuajse vinë nga një planet tjetër.

Shkaqet që e mundësuan, që kjo letërsi të zhvillohej jashtë trevës së Luginës janë të shumëta. Kur populli shqiptar që jetonte nën thundrrat e Jugosllavisë titiste, dhe përpjekjet e tij për të qenë të lirë në trojet e tyre autoktone, dhe kur po ushtronte terror jashtë mase, nëpër gjitha institucionet arsimore e kulturore ku shumica e shkrimtarëve të kësaj treve po e zbatonin me përpikmëri këtë sistem duke mos e ditur se një ditë, ajo do t'ua kthente në mënyrën më mizore madje edhe me shpërngulje.

Shqiptarët e Preshevës, Bujanocit e Medvegjës të bezdisur nga këto kuzhina të njelmëta, u detyruan të zgjedhin një tjetër model për t'i prirë proceseve, që do t'i dalin përpara si hije ku do të finalizojnë njëherë e përgjithmonë të ardhmen e tyre.

Kur Jugosllavia e Titos, ishte duke e dhënë frymën e fundit diku nga vitet 1990-1992, u pa e udhës që shqiptarët të mos rrinë duarkryq por të zgjohen nga kllapia shekullore që nuk mundën të ngrejnë kokën sepse historia kishte filluar tik-taket e saja. E para iniciativë do të jetë kur brezi i politikanëve dhe shkrimtarëve, do të marrin vendim që më 1 dhe 2 mars të vitit 1992 të dalin në Referendum, me të drejtë bashkimi me Kosovë që ishte ngjarja më madhore, që u shkrua në koluaret më të rëndësishme historike që ende sot po me këtë iniciativë pretendojmë të bashkangjitemi me Republikës së Kosovës, dhe tjetra do të jetë kur lufta e fundit 1999-2000, rezultoi që në Marrëveshjen e Kumanovës, Lugina e Preshevës të jetë jashtë trungut shqiptar.

Pas këtyre ngjarjeve, Serbia filloi spastrimin etnik të kësaj treve me metoda më ç'njerëzore duke i ndjekur ish- luftëtarët të cilët morën pushkën për çlirimin e vendit, si dhe fshirjen e njerëzve më eminentë nga regjistri civil, ku si pasoj e saj filluan edhe përndjekjet masive ndaj këtyre individëve.

Këto shkaqe e bënë të mundur, që për të siguruar një jetesë më të mirë shkrimtarët që bënë nam i'a mësyen diasporës e madje edhe Kosovës që tashmë ishte e lirë, ku këta shkrimtarë do ta gjenin veten më mirë dhe do ta lëvronin letërsinë ashtu si duhej.

Periudha këto në të cilën ngjarjet shënojnë kapitull shumë sfidues, sepse kryekëput janë të mbushura me lloj-lloj ngjarje si kombëtare, letrare, politike e kulturore. Edhe pse të mërguar ata me mburrje e krenari do të shpërfaqin para gjithë shqiptarëve, idenë se edhe jashtë trungut në të cilën ke lindur mund të japësh kontributin tënd sadopak.

Ishte rrugë e mundimshme por edhe e bukur, sepse saherë që rri me këta shkrimtarë mund të mësosh shumë, sepse e di që jeta i ka degdisur në valët më të rënda të jetës, dhe ke çka mëson prej tyre. E pikërisht këto tema do të zënë vend mes raportit shkrimtarë-vuajte dhe vuajtje shkrimtar.

Elita e shkrimtarëve që jetuan, me këto modele të vuajtjes janë sot janë vula jonë krenare e për të cilët do të flasim më gjerësisht. I pari i cili do të hap siparin e letërsisë, më të dhimbshme

do të jetë një intelektual i cili në 1981, do të burgoset për veprimtari patriotike e që është *Reshat Avdiu* nga fshati *Bushtran* i Komunës së Preshevës, që i pari do të flas me veprat e tij për shqiptarët Masuricës të shpërngulur me dhunë nga serbët nga qyteti i *Surdulicës*, në veprën "*Terrori serb ndaj shqiptarëve të Masuricës dhe Vranjës*" 1878-1999.

I lindur më 1957, në një familje patriotike, ai do të bëhet krahu i djathtë patriotëve më të mëdhenj që sot janë vula e krenarisë kombëtare. Ai do të gjendet, përkrah *Hydajet Hysenit*, e *Kadri Zekës* që kishin hyrë udhës më të vështirë atë patriotike. I riu preshevar, tashmë kishte hyrë në një sferë që po kërkonte vullnete rinore, për t'u përballur me sfidat që kërkonin jetë a vdekje. Ai në këtë vepër do të fokusohet kryesisht, tek dy traktatet famëkeqe që Europa i kurdisi në dëm të truallit shqiptar gjegjësisht edhe tek shqiptarët e Masuricës që pas shpërnguljes me dhunë disa u ndalën në fshatin *Shoshajë*, të Komunës së Preshevës e disa u degdisën vise të tjera në diasporë e gjetiu.

Duke u bazuar në shkrimin e *Princit Obrenoviq* se: "*sa më pak që të ketë shqiptarë në mesin tonë, aq më e madhe do të jetë merita për atdhe dhe sa më shumë shqiptarë që të shpërngulni ju, aq më i madh do të jetë sukcesi për atdheun tonë*"¹, Reshati e përshkruan me ironinë më të madhe që një sistem i tillë që përjetoi familja e tij, ai flet me mallëngjimin më të madh duke i dhënë shpresë vetes, se një ditë do të dalin gjenerata me të cilën do të merren me këtë çështje, deri sa të ekzistoj kjo botë, sepse atë e brengos fakti se askush nuk e ndihmoi këtë instalim ç'njerëzor, ku u ndihmua edhe nga Europa lavire, siç e qujati edhe poeti ynë kombëtar, *Gjergj Fishta*.

Milëfin e tij, për shpërnguljen e muhaxhirëve të Masuricës ai e përshkruan me dëshirën më të madhe kur një pjesë e tyre u shpërngulën në fshatrat përreth si në *Raincë*, *Corroticë*, dhe muhaxhirët e shpërngulur me dhunë në *Shoshajë*. Siç na thotë edhe vet autori *Reshat*, gjatë shpërnguljes ishte krijuar edhe kënga e njëjtë, sikur ajo e *Pashko Vasës* "*Oj Shqypni e mjera Shqypni*" por me motiv për shqiptarët e Masuricës së *Vranjës* e *Surdulicës*, e përcjellë me fyell:

O, shqiptar t'i o i mjerë

O, t'i ke metë si zogu n'therrë

O, asnjë kral o, asnjë mbret,

O, n'dynja krahun s'po n'a e jep.²

Pas gjithë këtij zjarri shpirtëror, autori dhe shkrimtari *Reshat* do të dënohet me gjashtë vjet e gjysëm burg për aktivitete patriotike, ku këto ditë fatkeqe do të kaloj në burgun e *Pozharevcit*. Por dëshira e tij ende vazhdon deri në vdekje se "*Tej Kosove me Toplicë e Çamëri, Shqipëria është një*", ku pasandej vazhdon se dielli do të lind atje tej maleve shqiptare dhe për muhaxhirët e shpërngulur me dhunë nga memleqeti i tyre i vjetër. Me këtë vepër *Reashti*, u bë *Promete* që saherë të lind dielli i shpresës, ai do të kujtohet brez pas brezi.

Një tribun tjetër i letërsisë shqipe, i cili do të lind në fshatin *Samolicë* të Komunës së *Bujanocit* që shënoi kthesë të madhe historike nga kjo trevë dhe e ngriti atë në piadestale më të mëdha është *Mustafë Ismaili* në realacion *Luginë- Kosovë- Kanada*. Luftës politike në vitet më fatkeqe të popullit shqiptar, edhe ky shkrimtar do të përballlet me vështirësitë më të mëdha për të ta zhvilluar mendjen dhe shkrimin në të cilën letërsia e tij sa e dhimbshme është edhe krenare.

¹ *Reshat Avdiu*, "*Terrori serb ndaj shqiptarëve të Masuricës dhe Vranjës*", Preshevë, 2006, fq. 2.

² Po, aty, fq. 21.

Viti 1999, atë do ta gjej në qytetin e Fushë Kosovës si mësimdhënë, dhe njeri që kishte filluar misionin atë të përhapjes së dritës dhe dëiturisë.

Por rruga e tij u ndal në gjysëm, sepse me plasjen e luftës në Kosovë ai u desh të shpërngulet nga aty, për një destinacion që do ta dridh shpirtin e tij, por asnjëherë pesimist se nuk do të mundet të kthehet aty. Ai do të detyrohet të shpërngulet, në Toronto të Kanadasë ku do lëvron letërsinë e tij në mënyrë brilante dhe mbi të gjitha me tematikë nga Lugina.

Jeta e një mërgimtari është një jetë e dyfishtë..Ajo që e jeton çdo ditë këtu në kurbet, dhe ajo që i qëndron mbi supë e nuk i hiqet si barrë e rëndë e vendlindjes, e cila çdo ditë e më shumë ia dhez shpirtin për atë që po dëgjon dhe po përjeton e të mos kemi mundësinë të kthehemi. Sepse koha na shkeli, dhe nuk mbahen dy shalqinjë nën sjetullë. Biografia e mërgimtarit është e dhimbshme. sa më shumë jeton e vepron jashta vendlindje njerën jetë e jeton e tjetrën e humbës, duke u shterrur këtu në dhë të huaj. Vëmendjen nuk na e largojnë dot nga andej ku kemi lerë.

Ai nga Kandaja e largët, do të shkruaj këto vepra si "*Shtigjeve të natës*", "*Rruga pa Adresë*" "*Me luginasit e mi në Kanadanë e largët*" "*Monolog Mërgimtari*" e disa të tjera që e bëjnë letërsinë e tij jashtzakonisht të madhe. Ja se çka shkruan ai në hyrje të veprës së tij "*Shtigjeve të natës*", në relacionin e sotmja dhe e ardhmja ku thotë " *E shkuara nuk mund të fshihet, por e ardhmja akoma do të shkruhet*" pastaj vazhdon se: "*Po të kisha vdekur në këtë kohë të shkuar humbja do të ishte e madhe. Tani po i shoh pasojat e ardhmërisë. Faleminderit Zot, që më dha shansin të jetoj dhe ti zbardhë përjetimet në këtë libër, nga episodi i parë hapave të jetës sime me ngjarje të përjetuara*".

Tek vepra e tij më e mirë, "*Rruga pa Adresë*" sipas mendimit tim i qëndron fort stoicizmit të tij, ku nëpërmjet personazhit Tafa, libër i cili është kryekëput vepër autobiografike e autorit a është kujdesur që ky personazh të prekë ndërjegjen e lexuesit duke pasur parasysh se jetonte me sllavët, si fqinjë për shumë vite ai i mbajti me bukë, por që në fund ata kishin bërë plane që ta asgjësonin njëherë e përgjithmonë. Personazhet, apo fqinjët e tij serb si Rada e Sllobodani dhe jevgjit Rafeti e Reshati do ti sjellin atij shumë mundime sepse ata ishin të detyruar ti bëjnë shantazhe e madje kur edhe do ti digjet shtëpia një ditë *Tafës*, ata do të jenë organizatorët e këtij atentati. Pas gjithë këtyre vuajtjeve, ai do të marrë rrugën pa adresë, ku fillimisht do të vijë në Preshevë, Bujanoc, Miratocë madje edhe në Maqedoninë Veriore në Kumanovë e Llojan, por as këtu nuk do të gjej prehje nga okupatori sllav, që më në fund rruga e tij do ta ketë një adresë drejt qytetit të Torontos të Kanadasë.

Pas mbarimit të luftës, Tafa kthehet në Kosovë në shtëpinë e tij në Fushë Kosovë, por ç'të sheh. Shtëpia e tij ishte djegur, po nga ata fqinjët e tij serb të cilët i kishte dhënë bukë, por edhe ata tashmë kishin ikur duke i lënë marrëzitë dhe masakrat që i kishin bërë.

Intelektuali Tafa, pasi vjen nuk e harron edhe vendin e tij të punës atë në Shkollën Fillore "*Selman Riza*" ku ai kishte punuar profesor i gjuhës shqipe por edhe aty duke i parë kushtet e rënda dhe rrogat e dobëta e lë punën dhe përfundimisht shpërngulet në Toronto të Kanadasë deri në pensionim.

Pas gjithë këtyre katrahurave, vargani i shkrimtarëve preshevarë që kishin marrë rrugën e mërgimit nuk kishte të ndalur. Temat dhe motivet përvluese asnjëherë nuk e ndalën shpirtin krijues, që veprat e tyre të mbesin memoare të lavdishme. Ngjarjet që pasuan pas vitit 1989-1999,ngjallën edhe më tepër nostalgji që një ditë Lugina ta shoh dritën ashtu siç e meriton.

E pikërisht, pas këtyre ngjarjeve dolën në sipërfaqe edhe dy shkrimtarë me të tillë motiv, Hasan Emërllahu dhe Sadik Sadiku me monografinë e tyre "*Kronikë e një kohe 1989-1900. Lugina gjithçka për Kosovën*". Sadiku i lindur në fshatin *Rahovicë* të Komunës së Preshevës, shkollimin bazë do ta ketë në fshatin e tij të lindjes. Pas demonstratave të vitit 1981, ai do të

detyrohet si shumë të rinjë të shpërngulet që shtetin e Zvicrrës, ku prej vitit 1970 gjegjësisht pesëmbëdhjetë vjet me punë të përkohëshme siç na thotë edhe ai vet në këtë vepër.

Detyrën e shkrimtarit i'a kishte imponuar koha, sepse historia për shqiptarët e Kosovës kishte filluar mbrapshtë. Para se të merrte rrugën e mërgimit ai do të merr edhe një detyrë të rëndë sa i përket çështjes së veprimtarisë patriotike duke dhënë ndihmesë për shqiptarët e Kosovës që tashmë ishin të okpuar nga shteti serb. Do merr përsipër të themelojë Shoqatën Humanitare " Nënë Tereza" që kishte synim të kontribonte për shqiptarët e Kosovës gjatë periudhës së luftës.

Libri monografik përbëhet prej 21 kapitujsh, duke filluar nga fjala e redaktorit Jonuz Fetahaj, për të vazhduar me ngjarje e zhvillime nga më të rëndësishmet të ndodhura përgjatë një dhjetëvjeçarit jo vetëm në Preshevë, por edhe rreth saj në Kosovën Lindore.

Studiuesi dhe shkrimtari Sevdail Hyseni për këtë libër thotë se: "*i përbush të gjitha kriteret e të qenit një libër monografik, si nga aspekti teknik, po ashtu edhe përmbajtësor. Bashkautorët ia kanë dalë, të rrumbullakësojnë një periudhë kohore dhjetëvjeçare, me mjeshtëri e pedanteri, duke lënë një gjurmë veprimtarie humanitare dhe duke vënë një gurë në kalanë e rezistencës shqiptare për liri dhe pavarësi*".³

Prandaj edhe ky libër nga këta autor meriton respekt të jashtzakonshëm, për faktin se u çmua edhe më tepër sakrificat për lirinë e Kosovës por me një dhembje siç thonë edhe autorët që Lugina nuk i'u bashkangjiti Kosovës mëmë.

Një figurë tjetër e artit letrar, të cilën i parapriu letërisa shqipe, emri i të cilit u vlerësua lart është edhe emri i shkrimtarit të njohur preshevar *Mexhid Mehmeti*. Ai u lind në fshatin Zhunicë, të Komunës së Preshevës, por që figura e tij, shkëlqeu kur ai përfundimisht u shpërngul në Kosovë gjegjësisht në Fushë Kosovë.

Edhe ky shkrimtar pas përndjekjeve dhe persekutimeve që bëri sistemi jugosllav u detyra që të bëjë edhe punën e gazetarit gjatë vitit 1985, duke punuar në cilësinë e gazetarit në gazetën "Rilindja" si korrespondent i Kosovës Lindore. I shtyrë nga ngjarjet me të cilën po preokupohej kjo trevë, punën e gazetarit e kishte marrë si detyrim, që sado kudo t'a mbante të lidhur këtë trevë me Kosovën nënë.

Mexhidi një doajen i madh i letërsisë, gjatë karrierës së tij shkroi mbi 33 vepra, që për motiv kanë mallin për vendlindjen, dashurinë për letërsinë, jeta nëpër të cilën ka ecur ai, e shumë e shumë motive të tjera.

Për kontributin e tij, të jashtzakonshëm në fushën letrare për nder të 11 vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës, ai u dekorua me MEDALJEN PRESIDENCIALE TË MERITAVE, të dhënë nga ish-presidenti Hashim Thaçi.

Dashuria e tij për ta parë Luginën të bashkangjitur me Kosovë, nuk rreshti asnjëherë dhe saherë që zihet fjala për Kosovën Lindore, ai shton se, "*sa i përket pengut jetësor, mund të them se është Presheva, përkatësisht Kosova Lindore, e cila është ndarë padrejtësisht nga trungu amë dhe tani po përjeton njërën nga periudhat më të vështira të mbijetesës. Si kurrë më parë po përjeton zbrazjen e heshtur, në sy të botës demokratike, pa ndihmën e nevojshme të faktorit shqiptar të Shqipërisë e të Kosovës! Ah, shton Mexhid Mehmeti, – mos më daltë shpirti pa i parë të bashkuara të gjitha trojet etnike shqiptare! Ky ka qenë, është dhe do të jetë pengu im më i madh, derisa t'i mbylli sytë e të marr frymën e fundit" ka shtuar në fund, *Mexhid Mehmeti, shkrimtar dhe publicist i një kohe*"⁴*

³ Sevdail Hyseni, Vështrim mbi librin. Jetapress.com 20.05.2022.

⁴ rajonipress.com/mexhid-mehmeti-gjysmë-shekulli-me-artin-e-letërsisë.

Konglomerata e shkrimtarëve dhe intelektualëve, që dhanë kontribut të jashtzakonshëm janë edhe Akademikët tanë të rëndësishëm që tash e sa dekada, jetojnë në Republikën e Kosovës ku veprimtaria e tyre shkencore ka lënë gjurmë të thella në letërsinë tonë, bëhet fjalë për, *akademik Idriz Ajetin Rrapin shekullor nga Medvegja, akademik Rexhep Ismajli, akademik Hivzi Islami, akademik Nexhat Daci*, që janë emra mjaft të njohur në skenën ndërkombëtare, me prejardhje nga Lugina e Preshevës.

Përfundimi

Vitet më të vështira nxorrën në sipërfaqe, mallin përvëlues të çdo shqiptari të kësaj ane. Luftërat e njëpasnjëshme që ndodhën me shkak e pa shkak prishën rendin dhe qetësinë kudo ku jetonin shqiptarët. Mundësia e vetme, ishte që të migronin apo të ishin të persekutuar duke mos mundur aspak të ishin krijuar në vendin e tyre. Këta shkrimtarë të degdisur anekënd botës, i kishin vënë mision vetes se çështjen e Luginës së Preshevës do ta ngrinin në piaestale të rëndësishme. Edhe pse disa u syrgjynosën e u tretën, nëpër kazamatet jugosllave, prapë i'a rritën qëllimit që e kishin nisur, Kosova u shpall Republikë por zjarri mbeti i ndezur gjithmonë, se Lugina e Preshevës mbeti jashtë trungut të Republikës së Kosovës.

Sot e kësaj dite këta shkrimtarë, ende jetojnë. Disa me moshë të thyer e disa ende me shumë, emocione për karrierën të cilën ata e kishin nisur, por që vetëm vdekja do ti ndajë nga kjo moto sepse Lugina asnjëherë ska qenë tokë sllave, por autoktone, pellazge, ilire, që me shekuj kanë jetuar. Pas shumë e shumë përpjekjeve, amaneti i tyre deri në vdekje do jetë: "Mos e gëzofshim këtë jetë, po s'u bashkuam me Republikën e Kosovës.

Literatura

- [1]. Avdiu, Reashat, Terrori serb ndaj shqiptarëve të Masuricës dhe Vranjës (1878-1999), Preshevë, 2006.
- [2]. Emërllahu, Hasan, Sadiku, Sadik, Kronikë e një kohe (1989-1999), Lugina gjithçka për Kosovën, Lena, Prishtinë, 2021.
- [3]. Ismaili, Mustafë, Rruga pa Adresë, Meshari, Prishtinë, 2020.
- [4]. Hyseni, Sevdail Vështrim mbi librin. Jetapress.com 20.05.2022.
- [5]. rajonipress.com/mexhid-mehmeti-gjysmë-shekulli-me-artin-e-letërsisë.